



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR CAKTIMIN E VEPRIMEVE TË PÛRKOHËSHME PËR TRAJTIMIN E OBJEKTIT TË MBYLLUR SHKOLLOR SHFMU "DY DËSHMORËT" PARALELJA E NDARË FIZIKE NË DOBRAJË TË VOGËL

I. Me këtë Vendim përcaktohen veprimet për trajtimin e përkohshëm të objektit shkollor të mbyllur sipas Rekomandimit të MASHT për shkak të numrit të vogël të nxënësve.

II. Objekti shkollor i cili do të trajtohet në këtë fazë është:

- Objekti shkollor SHFMU "Dy dëshmorët" paralelja e ndarë fizike në Dobrajë të Vogël,

III. Me qëllim të mosdëmtimit dhe shkatërrimit të tij, objekti shkollor destinohet për përdorim për nevojat e arsyeshme të banorëve të fshatit të karakterit të përgjithshëm .

IV. Për menaxhimin e objektit të cekur shkollor do të kujdeset Këshilli i fshatit.

V. Për procedurën e transferimit të objektit të cekur tek Këshilli i fshatit do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

VI Objekti shkollor do të lejohet të përdoret nga banorët për një (1) ose disa ditë me Pëlqimin e Këshillit të fshatit dhe vetëm për aktivitetet që nuk bijnë në kundërshtim me rendin dhe sigurinë publike.

VII. Menaxhimi i objektit shkollor nga Këshilli e fshatit do të jetë i përkohshëm deri në marjen e ndonjë Vendimi tjetër nga Komuna.

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

IX. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim – Vendimi është përcaktuar me dispozitat nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Me datë 01.09.2026, Drejtorati për Arsim i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Komunës me të cilën ka kërkuar përcaktimin e veprimeve për trajtimin e objektit shkollor që në bazë të rekomandimeve të MASHT është bërë ristrukturimi i shkollës dhe me Vendimin për risistemim të DKA-së Nr.04-610/01-39105 të datës 11.08.2026 nxënësit që paraprakisht kanë vijuar mësimin në këtë objekt shkollor janë risistemuar në shkollën amë.

Përkitazi me këtë pasi objekti i cekur ka mbetur i zbrazët ekziston rreziku potencial se ai objekt mund të dëmtohet dhe për këtë arsye Drejtori i DKA -së ka kërkuar trajtimin e kësaj çështje nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal

Nga arsyet e cekura dhe në pajtim me dispozitat ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 610/05-46445
Lipjan, Më 04.09.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUARJE: PRIMJEKODANA:		02.09.2026	
NUMERI JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILLOG
01-610/01-	45652		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

DREJTORIA E ARSIMIT

Datë:	01.09.2026
Për:	Imri Ahmeti Kryetar i Komunes
Nga:	RASIM HASANI Drejtore për Arsim
Lënda:	Kërkesë për caktimin e veprimeve të përkohëshme për trajtimin e objekteve të mbyllura shkollore



E nderuar,

Ju lutem që të kryeni procedurat për caktimin e veprimeve për trajtimin e objektit shkollore në Dobraj të Vogel. Vendimi për kto procedura duhet të kalojë në Kuvendin Komunal pasi me vendim Drejtoria e Arsimit Komunal ka marrë vendim që nxënësit në shkollën Dobraj të Vogel të ristemohen në shkollën am.

Shtojc: Vendimi për risistemin



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MINICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ARSIM

Nr. 04-610/01-39105
Më: 11.08.2026

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për arsimin parauniversitar Nr.04/L-032, Ligjit për nenit 45 paragrafi 45.5 Ligjit për Arsim në Komunitat e Kosovës Nr. 03/L-068 dhe nenit 50 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 dhe, Drejtori i Drejtoratit Komunal për Arsim, nxjerr:

**V E N D I M
P Ë R R I S I S T E M I M**

1. Risitemohen nxënësit të cilët vijnë procesin mësimor në SHFMU "Dy Dëshmorët" PNF Dobrajë e Vogël në shkollën amë.
2. Stafi arsimor dhe mbështetës që punojnë aktualisht në atë paralele do të risistemohen në pozita të njëjta në institucione shkollore të ndryshme të komunës së Lipjanit.
3. Objekti shkollos mbetet në pronësi të komunës së Lipjanit dhe do të trajtohet përmes Kuvendit Komunal të Lipjanit.

Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Pas kërkesës dhe takimeve me komunitetin e fshatit, duke u mbështetur në dispozitat e legjislacionit në fuqi, si dhe duke marrë parasysh nevojën për sigurimin e vazhdimësisë së procesit mësimor dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për nxënësit dhe personelin e institucionit arsimor është vlerësuar e nevojshme që nxënësit të cilët vijnë procesin mësimor në SHFMU "Dy Dëshmoret" PNF Dobrajë e Vogël të vazhdojnë procesin mësimor në shkollën amë. Gjithashtu stafi arsimor dhe mbështetës të cilët janë të angazhuar në këtë shkollë do të risistemohen nëpër institucione tjera arsimore të Komunës së Lipjanit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. DKA-së;
2. Arkivit
3. Shkollës

